



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 4159/5 prot.

Tiranë, më 12. 09. 2022

URDHËR

Nr. 429, Datë 12. 09. 2022

“PËR
MARRJEN NË DORËZIM TË REGJISTRAVE DHE AKTEVE NOTERIALE TË
NOTERIT DEAR (DEHAR) MUÇA”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7 të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, Urdhrit nr.167, datë 10.06.2020 “Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale, regjistrave dhe vulave të noterit”,

KONSTATOJ:

Me Urdhrin nr. 383 datë 17.06.2021, të Ministrit të Drejtësisë është vendosur heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit z. Dear (Dehar) Muça, për shkak se ushtronte veprimtarinë noteriale në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Në këto kushte, lind nevoja për ngritjen e një komisioni për marrjen në dorëzim të regjistrave dhe akteve noteriale, të ish-noterit z. Dear Muça, me qëllim mbarëvajtjen e punës dhe mospengimin e shtetasve për pajisjen me akte noteriale të cilat ndodhen në arkivën e ish noterit, si dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të vulës së thatë dhe të njomë të ish-noterit.

Për sa më sipër, bazuar në Ligjin nr. 110/2018 “Për noterinë”, në pikën 1 dhe 2 të Urdhrit nr. 167, datë 10.06.2020 “Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale, regjistrave dhe vulave të noterit”, si dhe pas administrimit të shkresës nr. 4159/1 prot., datë 28.07.2022 të Dhomës Kombëtare të Noterisë, si dhe shkresës nr. 4159/2 prot., datë 12.08.2022 të Degës Vendore të Noterisë Shkodër,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të arkivës noteriale të noterit z. Dear (Dehar) Muça, i përbërë nga antarët e mëposhtëm:
 - a.) Z. Endrit Kalaja, specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - b.) Znj. Diana Toro, specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - c.) Z. Sabri Kurtaj, përfaqësues nga Dega Vendore e Noterisë Shkodër;
 - d.) Z. Arben Kopliku, përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

2. Ish-noteri, personi i autorizuar prej tij përmes prokurës së posaçme ose personi që ka në ruajtje arkivën i dorëzon regjistrat, aktet noteriale dhe vulat përkatëse Komisionit të ngritur në pikën 1 të këtij urdhri, në ditën dhe orën që është caktuar në marrjen e njoftimit përkatës.

3. Komisioni për marrjen në dorëzim të arkivës, merr në dorëzim me procesverbal të nënshkruar nga të gjithë antarët dhe noteri, regjistrat dhe aktet noteriale të arkivit të noterit dhe vulat përkatëse.

4. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, anëtarët e komisionit të caktuar në pikën 1, të këtij urdhri, të verifikojnë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojnë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.

5. Arkiva t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 60 ditor, noterit të Degës Vendore të Noterisë Shkodër **z. Ilir Krashi**, pas verifikimit nga ana e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të arkivit, se noteri plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivit dhe kryerjen sa më të shpejtë e cilësor të shërbimit ndaj të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

6. Komisioni i ngritur në zbatim të këtij urdhri kryen dorëzimin e regjistrave dhe akteve noterial noterit **z. Ilir Krashi**, të caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Shkodër, si dhe kryen asgjësimin e vulës së thatë dhe vulës së njomë, të ish-noterit Dear (Dehar) Muça.

7. Ngarkohet Sektori Arkiv – Protokollit për njoftimin e këtij urdhri personit përgjegjës si dhe ish-noterit Dear (Dehar) Muça.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ULSI MANJA

